

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Mysafiri i dites në xhaminë Wil

Imam Sulejman Bugari, Imam ne xhamine Vratnik ne Sarajeve



E shtune, 4.12.2010

Ne namain e drekes, ne kete dite dimrore, viziton Imami i nderuar dhe shume i mirenjohur ne Bosnje dhe me gjere, Imam Bugari, xhamine Wil. Ne prezencen e me shume se 60 xhematlijeve prezentohet imami i nderuar me nje teme jashzakonisht te qelluar para xhematit ne Wil.

Se muslimani nuk duhet te mburet me pasurine e tij, me dijen e tij, me poziten e tij, eshte obligim i qarte i tij. Njeriun e sprovon Allahu me shume gjera, mesin e tyre edhe me fene e tij dhe humbje ne pasuri dhe pozite. Askush nga ne nuk guxon te e mposht tjetrin ne keta pike.

Ne muslimanet nuk kemi flijuar me pasuri, autoritet dhe me familje per te arritur ketet din te paster. Ky eshte edhe shkaku, pse ne nuk ia dime edhe vleren kesaj feje.

Perendimoret ia dine vleren, ngase ata duheshte ta japin vendin e punes per hire te kesaj feje, duheshte te ndahen edhe nga bashkeshortet e tyre, per shkak se ata nuk kane qene dakord me kete

ndryshim rrenjesore ne jeten e ketij personi. Nga ky shkak keta njerez ndryshe sillen me Islamin dhe me Muhamedin a.s., perderisa ne e kemi mare kete fe falas, pas asnje sakrifikim, sic u shpreh ky mysafir.

Imami i xhamise ne Vratnik nuk ngurroi t'iu pergjigjet edhe pyetjeve interesante qe erdhen nga xhemati.

Xhematit ne Zvicer i interesoi se si jetonin besimtarete musliman ne Bosnje dhe si jane rrethanat islame atje ne raport me jeten para luftes. Imami i nderuar u pergjigj se Islami eshte tani me kualitativ se ai para luftes. Njerzit jane bere me te vetedijshem per identitetin e tyre dhe se vetedija fetare eshte zgjuar.

Imam Sulejman Bugari lavderon edhe angazhimin e imamit ne Wil per debatet e hapura me popullaten Zvicerane dhe koontributin e tij per davetin Islam. Ne baze te informatave te tij, eshte nga imamet e rralle ne Zvicer qe eshte i gatshem te debatton ne menyre te drejtperdrejt.

Sa i perket iniciatives per ndertimin e minareve, ai tha se do ti vije koha edhe

kesaj, por ne shiqim te pare, muslimanet duhet te kene neper xhamia me shume se 10 xhematlij qe e falin xhumane. Perderisa muslimanet celin ne secilin qosh nga nje xhami dhe i kan nga dhjet xhemat per xhuma, sju duhet minare. Minarja e tyre eshte bashkimi i tyre.

Mbas nje debati interesant, ai Iranoi nga imami i xhamise nje dhurate modeste dhe leshoi lokalim e xhamise ne nje atmosfere te ngrohte vllazerore. Te gjitha u renditen per te percjell kete mysafir te mirepritur.

Me shprese se do te takohen edhe nje here, sikur para disa muajsh rinistet e xhamise ne xhamine e tij ne Vratnik, e percjellin veturen e mysafireve duke u ndare fizikisht me te por jo edhe shpirtorisht.

Mbi Personin :

Sulejman Bugari ka lindur ne Rahovec te Prizrenit. Medresen e kreu ne Sarajeve kurse fakultetin ne Medine. Ai u punesua ne xhamine e qarshise ne Sarajeve, qe me vone u shperngul ne xhamine e Vratnikut.

Ai ka shkruar dhe perpiluar me shume tekste dhe libra. Nga librat e tij te njohur jane, "ti kthehemi Zotit", "ne jemi dhurata me e mire per njeri tjetrin" sidhe ligjeratat, "ligjeerata dhe shoqerime".



dhjetorë, 2010
UMMAH – Rinistët Wil